



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TRANSPORTIT  
DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTRI

URDHËR

Nr. 15, datë 30/01/2015

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË  
INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE NË  
MINISTRINË E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS, SI DHE NË  
INSTITUCIONET E VARËSISË”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.9367 datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”,

U r d h ë r o j :

1. Miratimin e Rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe në institucionet e varësisë”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Rregullorja nr.35, datë 24/02/2011, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit dhe në institucionet e varësisë“, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Edmond Haxhinasto



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TRANSPORTIT  
DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTRI

**RREGULLORE**

**PËR  
PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E  
FUNKSIONEVE PUBLIKE NË MINISTRINË E TRANSPORTIT DHE  
INFRASTRUKTURËS, SI DHE INSTITUCIONET E VARËSISË**

**KREU I  
DISPOZITA TE PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Baza Ligjore**

Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesit në ILDKPKI, bazohet në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe në ligjin nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

**Neni 2**

**Objekti dhe Qëllimi**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësive dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe marrjen e masave disiplinore në rastet e konfliktit të interesit.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është garatimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në mbështetje të realizimit të objektivit dhe detyrave kryesore të institucionit, në interesin më të mire të mundshëm të publikut e të besimit të tij, ndaj institucionit,

nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publike dhe atyre private të një zyrtari, në ushtrimin e funksioneve të përcaktuara vendimmarrëse në MTI, si dhe të institucioneve në varësi të sa, të cilat nuk kanë Autoritet Përgjegjës më vete.

### **Neni 3**

#### **Përkufizime**

"Zyrtar" është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike në MTI.

"Person i lidhur me një zyrtar të MTI-së" është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore, me zyrtarin sipas përcaktimit të pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar

"Parim i proporcionalitetit" (sipas nenit 46 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar), është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësi dhe kompetencave të një zyrtari të MTI-së me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave veti.

### **Neni 4**

#### **Fusha e zbatimit**

Rregullorja përcakton norma të detyrueshme për t'u zbatuar nga::

1. çdo zyrtar i MTI, që ndodhet në pozicione, ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron kompetenca të llojeve konkrete, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në ligjin nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar:
  - Ministri,
  - Zevendësministri i Transportit dhe Infrastrukturës,
  - Drejtori i Kabinetit,
  - Këshilltarët e Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës,
  - Sekretari i Përgjithshëm,
  - Drejtoret e Përgjithshme, në Ministri,
  - Drejtorët e Drejtorive në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës
  - Drejtuesit e institucioneve, në varësi të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, të cilat nuk kanë Autortitet Përgjegjës.
2. çdo zyrtar i MTI-së, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për akte dhe kontrata administrative;

3. çdo zyrtar i MTI-së kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për kontrata, që krijojnë marrëdhënie juridiko-civile, me palë këto subjekte;
4. personat e lidhur në masën dhe mënyrën e përcaktuar në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në nenin 37 të Kodit të Procedurave Administrative. Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës.

## **Neni 5**

### **Çastet paraprake të vendimmarrjes**

Për qëllimet e kësaj rregulloreje:

- a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;
- b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara si më poshtë:
  - i) hartimin e projektaktit nga zyrtari ose zyrtarët dhe dorëzimin organit apo zyrtarit kompetent për vendimmarrje;
  - ii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, për këtë projektakt nga zyrtarë të tjerë, brenda apo jashtë institucionit;
  - iii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, nga çdo zyrtar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projektakt;
  - iv) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, të çdo zyrtari me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;
  - v) përfshirjen e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqërues të një vendimmarrjeje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet, strategjitë, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e përgjegjësitë administrative pa praninë e të cilëve nuk do të vendosej dhe mbështetëj përmbajtja përfundimtare e projektaktit ose projekt-kontratës në tërësinë e tyre;
  - vi) çdo rast tjetër në përputhje me specifikat konkrete e perkatëse të misionit e të veprimtarisë së MTI-së.

## Neni 6

### Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt

1. Një zyrtar i MTI-së ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas nenit 4 të rregullores, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.

2. Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt, përfshihet, në secilin nga çastet paraprake të mësipërme të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:

a) roli zyrtar urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negocimin, propozimin, këshillimin, miratimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;

b) zotërimi i informacionit, që lidhet kryesisht me të dhëna sensitive për subjektet dhe ose ish-subjektet e MTI-së, të dhëna për tatimet e doganat, kuadrin rregullator, informacione sensitive personale, informacione për organet e hetimit e të ndjekjes, informacione për politikën ekonomike qeveritare dhe administrimin financiar;

c) çdo shkak tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të funksionit e të veprimtarisë së zyrtarëve të MTI-së:

3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje, përbën çast paraprak të vendimmarrjes apo kompetencë thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë, çdo rast i vlerësuar si i tillë nga autoriteti përgjegjës i MTI-së, i emëruar si i tillë nga Inspektori i Përgjithshëm, si dhe nga zyrtarët-eprorë në MTI.

4. Në secilin prej çasteve të mësipërme, zyrtari, pjesëmarrës në vendimmarrje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, është i detyruar të deklarojë, në zbatim të pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë rënien në konflikt interesi të çfarëdo lloji.

5. Në të njëjtat raste, eprori ose institucioni epror mund t'i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat private në zbatim të nenit 7 , pikës 2 të ligjit 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar.

6. Kur vlerësohet se ka rrezik për rënien në konflikt interesi të zyrtarit, veprohet sipas nenit 37 të ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005.

## Neni 7

### Interesat private

1. Interesat private të një zyrtari janë ato interesa që parashikon neni 5 i ligjit 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, e konkretisht:

- a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;
- b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
- c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;
- ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;
- d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
- dh) marrëdhënie:
  - i) familjare apo të bashkëjetesës;
  - ii) të komunitetit;
  - iii) etnike;
  - iv) fetare;
  - v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;
- e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në ligjin 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.

3. Nëse në ligjin 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për kriteret e përcaktuara në ligjin 9367 datë 07.4.2005, i ndryshuar, dhe anasjelltas.

4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesi privat i zyrtarit nga ata të përcaktuar në nenin 5 të ligjit 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3 të ligjit të lartpërmendur.

## KREU II

### PROCEDURAT DHE MJETET PER IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KONFLIKTEVE RAST PAS RASTI TE INTERESAVE

#### Seksioni 1

#### Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konflikteve rast për rast të Interesave

#### Neni 8

##### Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit

1. Çdo zyrtar, sipas përcaktimit të këtij termi në pikat 1, 2 e 3 të nenit 4 të kësaj rregulloreje, në ushtrimin e kompetencave apo në kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, detyrohet të bëjë vetedeklarim paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesave të tij private, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi.
2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtaret, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni epror.
3. Deklarimi, si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.
4. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimarrje për një akt.
5. Titullari i insitucionit, Sekretari i Përgjithshëm, me mbështetjen e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, në bazë të vetdeklarimit të nëpunësve si dhe në bazë të të dhënave që ka, merr masat e nevojshme, që të shmangë emerimin e një zyrtari në pozicione, në të cilat mund të lindin, ose ka konflikt interesash, apo që atij të mos t'i ngarkohen detyra, që mund të çojnë në shfaqjen e konfliktit të mundshëm të interesave.

#### Neni 9

##### Identifikimi i interesave private të zyrtarit nga persona të tretë

1. Ofrimi i informacionit, për interesat privatë të zyrtarit në MTI, është:
  - a) detyrë e çdo zyrtari që ka dijeni;
  - b) e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi, që ka dijeni dhe që ka një interes në përgjithësi e që përputhet me qëllimin e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
2. Burime të tjera informacioni për interesat privatë të një zyrtari dhe punonjësi të MTI-së mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në nenin 9 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

## Neni 10

### Lëshimi i autorizimit nga zyrtari

1. Autoriteti Përgjegjës ve në dispozicion të zyrtarëve të përcaktuar në nenin 4, me modelin e autorizimit, që ai duhet të lëshojë në favor të institucionit, jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, ose nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës, nëpërmjet të cilit institucioni autorizohet të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për zyrtarin, kudo ku ai është regjistruar.
2. Autorizimi dorëzohet në Autoritetin Përgjegjës të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

## Neni 11

### Autoritetet Përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave

1. Autoriteti Qëndror Përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit.
2. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe të kësaj rregulloreje, sipas hierarkisë janë:
  - a) Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës;
  - b) Zëvendësministri;
  - c) Sekretari i Përgjithshëm në Ministri;
  - d) Drejtorët e Drejtorive të Përgjithshme në Ministri;
  - e) Drejtorët e drejtorive në Ministri;
  - f) Drejtuesit e institucioneve në varësi të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, që nuk kanë Autoritet Përgjegjës më vete.
3. Autoriteti Përgjegjës në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, i cili zbaton detyrat e përcaktuara në ligjin nr.9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar dhe në nenin 12 të kësaj rregulloreje është Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

## Neni 12

### Detyrat e Autoritetit Përgjegjës të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës

Autoriteti përgjegjës i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës kryen detyrat e mëposhtme:

- a) mbledh dhe dokumenton interesat private të zyrtarëve të Ministrisë
- b) shpëndan dhe mbledh autorizimet e detyrueshme për t'u lëshuar nga zyrtarët, sipas nenit 10 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 dhe nenit 10 të kësaj rregulloreje;



- c) krijon regjistrin përkates dhe mban regjistrimet rast për rast të konfliktit të interesit;
- c) bazuar ne regjistrimin dhe vlerësimin e interesave private të zyrtarëve, u sugjeron atyre dhe/ose eprorëve të tyre, çështjet dhe momentet kur zyrtarët, dhe/ose eprorët e tyre duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e:
  - i.-** konfliktit rast për rast të interesit (faktik, ne dukje dhe të mundshëm);
  - ii. -** konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
- d) kryen, me autorizim të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës verifikimin e interesave të deklaruara apo të padeklaruara të zyrtarëve, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i jep ligji, dhe informon për këtë, sipas rastit titullarin e institucionit;
- dh) mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e gjobave në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005;
- e) përgatit guida, informon, këshillon e trajnon zyrtarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimit e tyre dhe me parandalimin sa më të mirë të konfliktit të interesave;
- ë) merr masa për të siguruar aksesin e informimit të publikut me të dhënat personale të zyrtarëve dhe dokumentet e tjera zyrtare, që lidhen me konfliktin e interesit; dhe në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse për çështjet juridike: të mëposhtme
  - i.** merr masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në konflikt interesi, zyrtarëve përgjegjës, si dhe mbështet Ministrinë, në ndërmarrjen e hapave ligjore për dëmshperblimin e paleve të treta të dëmtuara dhe kalimin e barrës së dëmshperblimit të zyrtarëve përgjegjës;
  - ii.** orientojnë, vlersojnë, kontrollojnë apo kryejnë hetim administrativ në lidhje me konfliktin e interesit të zyrtarëve të MTTI dhe të institucioneve në varesi, në përputhje me rregulloren dhe urdhrat e miratuara nga Ministri i MTTI;
  - iii.** shtrojnë çështje dhe kërkojnë këshilla nga Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, për zbatimin e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, kur kjo ka të bëjë me çështjen e konfliktit të interesave;
  - iv.** merr masa për të miratuar në rregulloret e brendshme të Ministrisë, udhëzimet e orientimet e lëshuara nga çdo institucion epror, si dhe nga ILDKPKI;
- f) mbështet ILDKPKI-në, në kryerjen e deklaramit periodik të interesave nga zyrtarët e Ministrisë;
- g) njofton me shkrim ILDKPKI-në, për rastet e emerimit dhe largimit nga funksioni të zyrtarëve, që mbartin detyrim për deklaramit të interesave private periodike në ILDKPKI, sipas rastit;
- gj) bën me dije zyrtarët e Ministrisë për çdo këshillë apo udhëzim të ILDKPKI-së;
- h) mbështet misionet monitoruese, vlerësuese apo të verifikimit dhe të hetimit administrativ të ILDKPKI-se, në institucionin e tyre ose në institucionet e varësisë;
- i) ndjek e zbaton detyra të tjera, që i ngarkohen sipas kësaj rregulloreje ose urdhrave të titullarit të institucionit në zbatim të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.

## Neni 13

### **Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave**

1. Për regjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave të zyrtareve të Ministrise se Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe institucioneve të varesisë, krijohet regjistri me të njëjtin emër.
2. Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave administrohet nga Autoriteti Përgjegjës i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

## Neni 14

### **Regjistrimet rast për rast të konflikteve të interesit**

Autoriteti përgjegjës, për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistron identitetin e zyrtarit të MTT-së, interesat privatë të tij, shkak për konflikt interesit, thelbin e konfliktit, palët e interesuara, burimin e të dhënave, mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre, si dhe vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprrorët, nga Kuvendi ose nga gjykatat.

## Seksioni 2

### **Identifikimi dhe regjistrimi periodik i interesave private**

## Neni 15

### **Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklaram periodik të interesave private**

1. Deklarimi i interesave private periodike të zyrtarëve të MTT-së bëhet në përputhje kërkesave të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
2. Zyrtarët e Ministrise se Puneve Publike dhe Transportit si dhe te institucioneve te varesise, te cilet jane te detyruar te bejne deklaram te interesave private periodike jane:
  - Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës
  - Zevendesministri;
  - Drejtori i Kabinetit,
  - Keshilltaret e Ministrit te Transportit dhe Infrastrukturës
  - Sekretari i Pergjithshem;
  - Drejtoret e Pergjithshem, ne Ministri,
  - Drejtoret e Drejtorive ne Ministrine e Transportit dhe Infrastrukturës
  - Drejtuesit e institucioneve, ne varesi te Ministrise se Transportit dhe Infrastrukturës, të cilat nuk kanë Autortitet Përgjegjës.
4. Gjithashtu, në zbatim të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, mbartin detyrim për deklaram të interesave private periodike

bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të zyrtarëve të MTI-së, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe kur këta të fundit nuk janë në të njëjtën gjendje familjare me zyrtarin

5. Çdo zyrtar i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, në rast largimi nga funksioni dhe në rast se nuk është më subjekt i deklaramit të interesave private periodike në ILDKPKI, ose kur kalon në një pozicion, që nuk mbart detyrimin për deklaram, është i detyruar, që brenda 15 ditëve nga data e largimit nga funksioni, të plotësojë dokumentin zyrtar “Deklaratë pas largimit nga funksioni”. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, si dhe Sektori i Financës, nuk mund të bëjnë dorëzimin e librezës së punës, të librezës së kontributeve shoqërore, të çdo dokumenti tjetër, si dhe pagimin e pagës së fundit dhe/ose shpërblimeve që mund t’i takojnë zyrtarit, në rast se ky i fundit nuk plotëson këtë detyrim ligjor.

## **Neni 16**

### **Mbrojtja për dhënien e informacioneve**

1. Çdo shtetas, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga zyrtarët e MTI-së, përfiton, mbrojtje të veçantë administrative, si më poshtë:
  - a) zyrtari i MTI-së, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi shtetasin informues (qofte ky dhe subjekt i MTI-së), dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit;
  - b) kur marrja e masës ndaj shtetasit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një zyrtar tjetër, që qëndron në marrëdhënie varësie vertikale mbi zyrtarin, për të cilin është dhënë informacioni.
2. Nga parashikimi i pikës 1 (b) të këtij neni bën përjashtim rasti kur marrja e masës administrative bëhet në kushtet kur konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm i zyrtarit të MTI-së është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
  - a) kur zyrtari i MTI-së, është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;
  - b) kur vetëpërjashtimi i zyrtarit është i pamundur, sepse është e pamundur delegimi i kompetencave të tij tek një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës;
  - c) kur vendimet e zyrtarit të MTI-së, sipas rregullimeve me ligj, nuk i nënshtrohen miratimit, revokimit ose shfuqizimit nga një institucion epror;
  - d) kur nuk është i mundur transferimi a tjetërsimi i interesit privat, për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare etj.);
  - e) kur nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, zyrtari i MTI-së të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni. Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtrohen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga Inspektori i Përgjithshëm

ose nga Kuvendi, të ngarkuar me ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen kurdoherë publike.

## **Neni 17**

### **Kufizimi i interesave private për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta**

1. Ministri dhe Zevendesministri i Ministrise se Transportit dhe Infrastukturës:
  - a) nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik;
  - b) nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër fitimprurëse,
  - c) nuk mund të zotërojë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, të çdo forme.

2. Zyrtaret e tjere:

- a) nuk mund të ushtrojnë asnjë funksion tjetër publik;
- b) nuk mund të ushtrojnë asnjë veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies;
- c) mund të zotërojnë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, pa asnjë kufizim, me përjashtim të rastit kur shoqëria ushtron veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit të MTT-së dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këto shoqëri apo mbi shoqëri të tjera, që bashkëpunojnë ose konkurojnë me shoqërinë në fjalë, rast në të cilin zyrtari mund të zotërojë aksione ose pjesë në kapital vetëm, në përputhje me kushtet e përcaktuara në shkronjën "c" të nenit 27 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;

## **Neni 18**

### **Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale**

1. Është e ndaluar që një zyrtar në MTT të kërkojë, të pranojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, për familjen, të afërmit, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij në MTT, nga një individ, person fizik ose juridik privat, nga subjekte të deklaramit të interesave private periodike në MTT, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji, ose që ndikon ose duket sikur ndikon në paanshmërinë e kryerjes së detyrës a është ose duket sikur është shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.

a) “Dhurata”, sipas kësaj rregulloreje ka të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në VKM-në nr.714, datë 22.10.2004;

b) Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të këtij neni, dhuratat, të cilat i ofrohen zyrtarit si pasojë e lidhjeve fafëfisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si nëpunës i administratës publike, të personit, që merr dhuratën.

2. Zyrtari nuk duhet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një zyrtar të një niveli më të lartë apo të afërm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga zyrtarë të një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.
3. Rregullat e mësipërme nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar punonjës ose kolegë të tjerë, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e nëpunësit.
4. Pranimi dhe vlerësimi i dhuratave bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në VKM-në nr.714, datë 22.10.2004.
5. Në asnjë rast zyrtari i MTTI-së nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.
6. Përjashtohen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare

## **Neni 19**

### **Prania dhe kufizimi i interesave private të personave të lidhur me zyrtarin**

1. Person i lidhur me zyrtarin e MTTI-së, për kufizimet e interesave private të zyrtarëve, të përcaktuar në nenet 15, 17 e 18 të kësaj rregulloreje janë përkatësisht:
  - a) bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/ja;

b) çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim.

2. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin e MTT-së, të përcaktuara në këtë rregullore, zbatohen edhe për personat e lidhur me të, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.
3. Përsa i përket kufijve të zotërimit të aksioneve ose të pjesëve në kapital, për zyrtarin e MTT-së dhe personin e lidhur me të, zbatohen drejtëpërdrejt parashikimet e nenit 24, pikat 4 e 5 dhe nenit 35, pikat 2 e 3, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
4. Personi i lidhur me zyrtarin e MTT-së, nuk mund të ushtrojë veprimtari si person fizik tregtar ose ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, nëse veprimtaria përputhet ose pritët me sferën e juridiksionit të zyrtarit të MTT-së dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte individuale apo normative të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nMTTjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këtë person fizik apo mbi shoqëri tregtare e persona të tjerë fizikë, që bashkëpunojnë ose konkurojnë me personin e lidhur. Kjo pikë nuk zbatohet kur plotësohet kushti i mëposhtëm:
  - a) veprimtaria dhe/ose disa veprimtari tregtare së bashku të një personi të lidhur krijojnë një të ardhur të përgjithshme bruto vjetore, që nuk tejkalon kufirin e parashikuar nga ligji.

## **Neni 20**

### **Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave**

1. Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave për zyrtarët e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, apo të institucioneve të varësisë bëhen sipas kreut IV të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.
2. Disa nga mënyrat bazë të menjanimit të konfliktit të interesit janë:
  - të mos i ngarkohen zyrtarit detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti interesash;
  - të mos lejohet që zyrtari të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes;
  - të merren masat e nevojshme për të shmangur emërimin ose zgjedhjen e një zyrtari në funksione, në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash;
  - në rast të një akti të marrë në praninë e konfliktit faktik të interesit, në çdo Mënyrë, që kjo vëhet re, të anulohen ose të revokohen, aktet e marra nga zyrtari, sa më parë, që të jetë e mundur, dhe mundësisht para se ato të kenë sjellë pasoja;
  - anulimi ose revokimi i aktit mund të bëhet edhe kur gjykohet se akti është marrë

- në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, i cili mund të shfaqet rast për rast ose në mënyre të vazhdueshme;
- anulimi ose revokimi i një akti nuk bëhet nga eprori i zyrtarit, kur ai vlerëson se pasojat, që mund të vijnë nga anulimi ose revokimi i tejkalojnë dukshëm përfitimet nga ky anulim ose revokim.

## **Neni 21**

### **Llojet e interesave private, që deklarohen periodikisht**

1. Interesat privatë, që deklarohen periodikisht janë:

a) pasuritë, detyrimet financiare, si dhe të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë";

b) ata të përcaktuar në shkronjën "e" të pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, përjashtuar premtimet dhe favoret, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale. Nuk deklarohen dhurata ose trajtimi preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi;

c) ata të përcaktuar në shkronjën "d" të pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, përfshirë çdo lloj të ardhure, të krijuar nga kjo veprimtari ose angazhim.

2. Interesat privatë, të përcaktuar në shkronjën "dh", "iii", "iv" dhe "v" të pikës 1 të nenit 5, si dhe përkatësia në organizata politike, në kuptim të shkronjës "d" të pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, nuk deklarohen dhe nuk kërkohet të deklarohen.

3. Interesat privatë të llojeve të tjera nga ato të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji mund të kërkohen të deklarohen periodikisht, nëse kjo është e mundur dhe e përshtatshme për nënloje interesash brenda këtyre llojeve, sipas përcaktimeve të Inspektorit të Përgjithshëm.

4. Kur zyrtari transferon të drejtat e zotërimit aktiv të aksioneve ose të pjesëve në kapital, sipas pikës 3 të nenit 38 të këtij ligji, në deklarimin periodik, për sa kohë vazhdon kjo gjendje, ai deklaron vetëm gjendjen e këtyre të drejtave para transferimit dhe frytet e pasurisë, të cilat ai ka marrë efektivisht gjatë vitit për të cilin bëhet deklarimi.

5. Në rastin e deklarimit para fillimit të punës, sipas të njëjtit kuptim të këtij termi, të përcaktuar në nenin 9 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", deklarohen vetëm:

a) interesat e përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, të grumbulluar deri në ditën e fillimit të detyrës, përjashtuar burimet e krijimit të tyre;

b) interesat e përcaktuar në shkronjën "d" të pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, por vetëm ato angazhime dhe veprimtari, që ekzistojnë në datën e fillimit të punës, përfshirë çdo lloj të ardhure të krijuar nga këto angazhime ose veprimtari nga data 1 janar deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit.

6. Deklarimi pas largimit nga funksioni, sipas të njëjtit kuptim të këtij termi, të shprehur në nenin 8 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", kryhet vetëm një herë, në datën e largimit nga funksioni, me përjashtim të rastit kur zyrtari fillon punë në një detyrë tjetër, që, sipas këtij ligji, vazhdon të mbartë detyrimin për deklarin.

7. Në deklarinin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në interesat privatë, të deklaruar më parë, sipas pikës 1 të këtij neni, interesat e lindur gjatë vitit që deklarohet dhe çdo e ardhur e fituar gjatë gjithë vitit për të cilin bëhet deklarin.

Të gjithë zyrtarët dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrim për deklarin, sipas pikave 1, 2 e 3 të nenit 14 të këtij ligji, detyrohen të paraqesin deklaratën e tyre, të mbyllur në zarf, deri më 31 mars të çdo viti, pranë autoritetit ose strukturës përgjegjëse të institucionit publik, të parashikuar në shkronjën "b" të pikës 2 të nenit 41 të këtij ligji.

Për zyrtarët e përmendur në pikën 6 të këtij neni dhe kur ata nuk mbartin detyrimin për deklarin, pika 7 zbatohet për periudhën nga deklarin i fundit deri në datën e largimit. Deklarin kryhet jo më vonë se 15 ditë nga data e largimit nga funksioni.

## **Neni 22**

### **Kundravajtje administrative**

1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përben vepr penale, përben kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobe, sipas kufijve të përcaktuar më poshtë:

a) për mosvetëdeklarin apo për mosdeklarin me kërkesë, në përputhje me pikat 1 e 2 të nenit 7 të këtij ligji, zyrtari dënohet me gjobë nga 5 000 (pesë mijë) lekë deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

b) për moslëshim autorizimi, sipas pikës 2 të nenit 10 ose të pikës 5 të nenit 14 të këtij ligji, zyrtari dënohet me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë;

c) Për mosdeklarin periodik në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarin, dënohet me gjobë nga 20 000 (njëzet mijë) lekë deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;



ç) për shkelje të nenit 21 pikat 1, 2 e 3, nenit 22, nenit 23 pika 1 dhe nenit 24 pika 4 të këtij ligji, zyrtari ose personi i lidhur me të, personi i besuar ose drejtuesi i shoqërisë dënohet me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 100000 (njëqind mijë) lekë;

d) për shkelje të pikave 1, 2, 3, 5 e 8 të nenit 38 të këtij ligji, zyrtari ose personi i lidhur me të dënohet me gjobë nga 100000 (njëqind mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë;

dh) kur paraqitet gjendja e përcaktuar në shkronjat "a" e "c" të pikës 6 të nenit 40, zyrtari dënohet me gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë;

e) në rastet e shkronjave të mësipërme të kësaj pike, gjoba jepet nga Inspektori i Përgjithshëm, me propozimin e eprorit ose të institucionit epror ose, kur shkelja verifikohet drejtpërdrejt, nga Inspektorati i Lartë;

ë) për shkelje të tjera të këtij ligji, Inspektori i Përgjithshëm, me propozimin e eprorit të strukturës së institucionit, në kuptim të shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 41 të këtij ligji, të institucionit epror, ose kur shkelja verifikohet drejtpërdrejt nga Inspektorati i Lartë, dënon personat përgjegjës me gjobë në masën 5000 (pesë mijë) lekë deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

f) për çdo masë administrative, Inspektori i Përgjithshëm njofton eprorin ose institucionin epror të zyrtarit të dënuar.

2. Gjobat janë më të larta, sipas vlerësimit të masës së shkeljes dhe sipas nivelit të rritjes së pozitës së zyrtarit.

3. Procedurat për zbatimin e masave administrative dhe ankimin ndaj tyre, rregullohen sipas Kodit të Procedurave Administrative.

4. Gjobat paguhen nga kundërvajtësi dhe derdhen në buxhetin e Inspektoratit të Lartë jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i gjobës. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga punëdhënësi, kur kundërvajtësi është në marrëdhënie pune, ose nga zyra e përmbarimit, me kërkesën e Inspektorit të Përgjithshëm.

## **Neni 23**

### **Masat disiplinore**

1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj nga zyrtarët përbën shkelje disiplinore, pavarësisht nga përgjegjësia penale apo administrative. Masat disiplinore zbatohen në përputhje me ligjet, që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe/ose statusin e zyrtarëve.

2. Inspektori i Përgjithshëm, për shkeljen e kryer nga anëtarët e strukturës përgjegjëse të institucionit, në kuptim të shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 41 të këtij ligji, i propozon titullarit të këtij institucioni largimin nga funksioni të këtij anëtari.

3. Mosdhënia e autorizimit, sipas pikës 2 të nenit 10 dhe pikës 5 të nenit 14 të këtij ligji, sjell ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin, që rregullon marrëdhëniet e punës.

## **Neni 24**

### **Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës**

Asnjëra nga dispozitat e kësaj rregulloreje nuk mund të interpretohet sikur i jep zyrtarëve të MTI-së, të drejta që të ndërmarrin ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt që synon cënimin e parashikimeve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në këtë rregullore.

Në mungesë të parashikimeve të veçanta në këtë rregullore, zbatohen drejtëpërdrejt dispozitat e përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

## **Neni 25**

### **Hyrja në fuqi**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.
2. Rregullorja e mëparshme dhe aktet që lidhen me të shfuqizohen

Edmond Haxhinasto